



*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë / /2025

Lënda: *Ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Vlorë, për hartimin e një plani konkret për përmirësimin e kushteve të strehimit të znj. N. M. .*

BASHKISË

VLORË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, siç jeni në dijeni, ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetases znj. N. M. , e cila është banore në Dukat. Kjo shtetase ankohet ndaj Bashkisë Vlorë, pasi së bashku me familjen e saj banon në një objekt banimi përdhes, i cili ka dëmtime të mëdha në elementët strukturorë si në themel, mure mbrojtës, çati etj., shkak i rrëshkitjes së dheut, sidomos pas shirave të vitit 2021. Kjo vërtetohet sipas raportit teknik të Institutit të Ndërtimit për qëndrueshmërinë e objektit, në bazë të së cilit banesa është konsideruar me rrezikshmëri të konsiderueshme për përdorim, pasi paraqet rrezik për sigurinë e jetës.

Ankuesja pretendon më tej se Bashkia Vlorë nuk e ka vënë në dijeni për fazën në të cilën ndodhet procedimi administrativ lidhur me procedurat e rindërtimit të banesës së saj dhe hapat e ndërmarra, bazuar edhe në rekomandimet sipas raportit teknik të Institutit të Ndërtimit.

Pas regjistrimit të kësaj çështjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se, ankesa e paraqitur plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal, ashtu edhe në atë substancial për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenin 13, shkronjën "a", të nenit 17 dhe shkronjën "b", të nenit 18, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (ligj nr. 8454/1999), ka vendosur ta pranojë atë dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor dhe konkretisht, pikës 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se:

"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij", si dhe shkronjës "b", të nenit 19, të ligjit nr. 8454/1999, ku parashikohet se: "Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin", i jemi drejtuar Bashkisë Vlorë, me shkresat "Kërkesë për shpjegime" nr. K3/N11-2 prot., datë 13.06.2022 dhe "Kërkesë e përsëritur për shpjegime" nr. K3/N11-3 prot., datë 31.03.2023, nr. K3/N11-4 prot., datë 02.06.2023, në të cilat i kemi kërkuar të na dërgonin informacion dhe dokumentacion për pretendimet e ankueses dhe arsyen se përse nuk është informuar lidhur me procedimin administrativ dhe fazën në të cilën gjendet ai, si dhe masat e ndërmarra nga institucioni për këtë qëllim.

Me shkresën nr. 4042/1 prot., datë 09.06.2023, Bashkia Vlorë, Drejtoria e Urbanistikës, është shprehur, ndër të tjera, se nga ekspertiza e mbajtur në terren nga specialistët e Drejtorisë së Emergjencave Civile, është konstatuar se objekti banesë i z. M. M. (bashkëshorti i ankueses) është ndërtim i vjetër, i pamirëmbajtur dhe janë evidentuar çarje të mureve, suvasë dhe dëmtim të dyshemesë. Bashkia Vlorë me shkresën nr. 15103/1 prot., datë 09.12.2021, i ka dërguar informacion të plotë Institutit të Ndërtimit, për dijeni ankueses, duke i kërkuar vlerësim të thelluar të gjendjes së objektit dhe propozim për ndërhyrjen e nevojshme.

Instituti i Ndërtimit në Tiranë ka dërguar Raportin Teknik në Bashkinë Vlorë me shkresën nr. 191/3 prot., datë 01.04.2022 duke rekomanduar si vijon:

- *Përforcim të themelit të objektit, ndoshta edhe përforcim të truallit të ndërtimit e cila duhet të përcaktohet pas një studimi të detajuar gjeologo-inxhinierik;*
- *Përforcim të të gjithë mureve mbajtëse, nyjeve të bashkimit dhe brezave të konstruksionit të çatisë;*
- *Rindërtim të pjesshëm të çatisë.*

Instituti i Ndërtimit shprehet se amortizimi i theksuar në vite është në masën 48.75%, referuar nenit 34 , pika 4 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019

“Për përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”, në të cilin parashikohet se nëse studimi i thelluar, ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së ndërtimit nga e para e ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës, vendos shembjen e detyruar të objektit, e cila kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 35 të këtij akti. Në përfundim, rekomandimi i tyre ka qenë që ndërtesa duhet të shembet dhe të rindërtohet sipas një projekti arkitektonik dhe konstruktiv bazuar në kodet moderne të projektimit. Gjithashtu, kanë kërkuar edhe marrjen e masave nga organet kompetente në bashkëpunim me pronarët e ligjshëm, për evakuimin e banorëve në godinë, në referencë të akteve ligjore, rregullave teknike, standardet në fuqi dhe praktikën më të mira të ndërtimit.

Me shkresën K3/N11-7 prot., datë 11.08.2023, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Bashkisë Vlorë duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion për masat e marra nga ana e tyre pas paraqitjes së Raportit Teknik nga Instituti i Ndërtimit për sa është në kompetencën e tyre si dhe nëse kishin dëshmipërblyer ankuesen, apo nëse kishin dorëzuar dokumentacionin tekniko-ligjor pranë institucioneve kompetente për dëshmipërblim të saj.

Me shkresën nr. 9785/1 prot., datë 31.08.2023, Bashkia Vlorë ka shprehur, ndër të tjera, se znj. N. M. nuk është trajtuar me ndihmë financiare sepse nuk i plotëson kriteret në bazë të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” (VKM nr. 329/2012), siç është kriteri “Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare: e) *“Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licensuara, nëse është rrëshqitje toke”*.

Bashkia Vlorë gjithashtu ka informuar se Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë saj ka shprehur, se në bashkëpunim me Njësinë Administrative Orikum kanë këshilluar qytetaren për largimin nga banesa dhe i është ofruar bonus qiraje në zbatim të legjislacionit në fuqi, por kjo është refuzuar nga ankuesja. Kjo drejtori, me shkresën nr. 4320 prot., datë 18.03.2021, ka referuar rastin pranë Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike pranë Bashkisë për përfshirjen e banesës së saj në programin *“Përmirësimi i kushteve fizike të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”*.

Sa më sipër, sërish institucioni i Avokatit të Popullit, i është drejtuar Bashkisë Vlorë, duke i kërkuar informacion si vijon:

- masat e marra pas paraqitjes së Raportit Teknik nga Instituti i Ndërtimit për sa është në kompetencën e tyre;
- cilin kriter nuk plotëson ankuesja për t’u trajtuar me ndihmë financiare bazuar në VKM nr. 329/2012, pranë organit kompetent;

- çfarë masash janë marrë për përfshirjen e banesës së ankueses në programin *“Përmirësimi i kushteve fizike të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”*.

Me shkresën nr. 13329/1 prot., datë 20.11.2023, Bashkia Vlorë ka informuar, se në muajin nëntor 2021, nuk janë evidentuar e nuk ka patur dëme nga fatkeqësitë natyrore, si pasojë e reshjeve të shirave në këtë periudhë. Nisur nga ankesa e znj. N. M. është ngritur komisioni i verifikimit të situatës faktike, komisioni i cili konstatoi se banesa është e vjetër mbi 50 vjeçare, e amortizuar dhe me rrisht për sa i përket banimit në të. Kjo gjendje e banesës nuk është shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore (shirat e nëntorit 2021). Bazuar edhe në raportin teknik godina është e amortizuar rreth 50% dhe kërkon ndërhyrje si meremetime e mirëmbajtje nga vetë ata.

Në këto kushte, Bashkia Vlorë është shprehur se ankuesja mund të trajtohet 1) me ndihmë financiare nga Njësitë e Vetëqeverisjes Bashkia Vlorë, si dhe 2) mund të përfshihet në programin *“Përmirësimi i kushteve fizike të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”*, në raport me kërkesat dhe nevojat e tjera të kësaj kategorie.

Bashkia Vlorë ka sqaruar më tej se me qëllim që ankuesja të përfitojë nga mundësia e parë, i duhet të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm, sipas VKM-së nr. 329/2012, pika 2, *“Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare. Sipas Bashkisë, deri tani nuk është plotësuar nga ankuesja dokumentacioni sipas kreut 3, shkronja “e”, “studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licensuara, nëse është rrëshkitje toke”*.

Gjithashtu, në lidhje me mundësinë e parashikuar në pikën 2, Bashkia Vlorë na ka informuar se Drejtoria e Mbrojtjes Civile i është drejtuar Drejtorisë së Informacionit dhe Zbatimit të Projekteve në Bashkinë Vlorë, për përfshirjen e mundshme të familjes së ankueses në programin *“Përmirësimi i kushteve fizike të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”*, e cila deri më tani nuk është përfshirë.

Sa më lart, duke analizuar se Bashkia Vlorë nuk ka marrë masa emergjente të cilat janë në kompetencë të tyre, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar sërish me shkresa të përsëritura, lidhur me rekomandimet e Institutit të Ndërtimit për rindërtimin nga e para të banesës, evakuimin e banorëve nga banesa; zgjidhjen për sistemimin e ankueses dhe familjes së saj pas evakuimit të menjëhershëm dhe gjatë pritjes nga ana e tyre të dhënies së ndihmës financiare për ndërtimin nga e para të banesës; mundësia e përfshirjes së ankueses në programet sociale të strehimit, sikurse cituar nga vetë Bashkia. Gjithashtu, nga ana jonë nuk ka qenë e qartë mosplotësimi i kriterit të dokumentacionit *“studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik*

Shqiptar ose subjekte të licensuara” nëse është rrëshqitje toke, duke kërkuar informacion dhe shpjegime lidhur me bazueshmërinë e këtij kriteri.

Sa më sipër, konstatojmë se Bashkia Vlorë nuk i është përgjigjur shkresave të institucionit të Avokatit të Popullit nr. K3/N11-11 prot., datë 01.02.2024, K3/N11-12 prot., datë 01.07.2024 dhe nr. K3/N11-13 prot., datë 15.10.2024.

Lidhur me këtë të fundit, ju bëjmë me dije, se mungesa e informacionit dhe dokumentacionit sa sipër cituar të kërkuar me shkresa të përsëritura (duke mos analizuar problematikën dhe mosmarrjen e masave nga ana juaj), si dhe mosdërgimi i tyre në kushtet kur ato vlerësohen të nevojshme për hetimin administrativ të rastit në fjalë, ka sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetares për të gëzuar efektivisht të drejtat e saj kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre, si dhe përbën pengesë në ushtrimin e misionit kushtetues të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në analizë të fakteve të deritanishme dhe të situatës konkrete, institucioni i Avokatit të Popullit, për të adresuar kushtet shqetësuese të jetesës me të cilat përballen ankuesja dhe familja e saj, kemi kërkuar vëmendjen dhe ndërhyrjen e Bashkisë Vlorë, pasi Avokati i Popullit është institucion kombëtar i të drejtave të njeriut, njëkohësisht nxitës i zbatimit në nivel lokal të politikave dhe standardeve të instrumentave ndërkombëtarë në këtë fushë.

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të qytetarëve ka qënë ndër vite në vëmendjen e shtuar të institucionit të Avokatit të Popullit, me prioritetin për përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, por jo vetëm.

E drejta për strehim është një prej të drejtave themelore më të rëndësishme të njeriut, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin dhe si e tillë përfshihet në një numër të konsiderueshëm të instrumentave të së drejtës ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 25.1 të saj, parashikon që: “Çdokush ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij dhe të familjes së tij duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin”.

Konventa të rëndësishme në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, sanksionojnë rëndësinë e respektimit dhe garantimit maksimal të kësaj të drejte.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë e regjimit tonë të brendshëm juridik, dhe jurisprudenca e pasur në këtë drejtim e GJEDNJ, sanksionon të drejtën për strehim si një të drejtë themelore të njeriut.

Konventa e të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore, kërkon marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të nxitur realizimin e së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Karta Sociale Evropiane dhe Karta Sociale Europiane e Rishikuar, neni 16 “E drejta e mbrojtjes sociale, ligjore dhe ekonomike e familjes cilëson: *Me qëllim që të sigurojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, e cila është bërthama themelore e shoqërisë, Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin mbrojtjen e jetës familjare ekonomike dhe sociale me anë të mjeteve të tilla si përfitimet sociale dhe familjare, marrëveshjet fiskale, ofrimin e strehimit familjar, përfitime për të sapo martuarit dhe mjete të tjera të përshtatshme.*

Neni 31 i Kartës Sociale Evropiane parashikon: “*Të drejtën e strehimit. Me qëllim që të garantojë zbatim efektiv të së drejtës për strehim, palët marrin përsipër masa të cilat:*

- nxisin aksesin tek strehimi i një standardi të përshtatshëm;*
- nxisin dhe zvogëlojnë mosstrehimin me qëllim eliminimin e plotë të tij;*
- ofrimin e çmimeve të shtëpive që janë të përballueshme për ata që nuk kanë mjetet e përshtatshme.”*

Sa më sipër, duhen pasur në konsideratë edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) për zbatimin e të cilave institucioni i Avokatit të Popullit kontribuon duke orientuar institucionet t’i qëndrojnë pranë qytetarëve më në nevojë, për të mos i rrezikuar pa ofrimin e shërbimeve. Një nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm është sigurimi i të gjithë qytetarëve, me prioritet shtresat në nevojë, për të patur të drejta të barabarta dhe qasje në shërbimet themelore. Deri në vitin 2030 duhet siguruar qasja në strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe të arritshëm për të gjithë. Zbatimi i Agjendës 2030 “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm”¹ është thelbësor, për sigurimin e mirëqënies dhe gëzimit të të gjithë të drejtave për qytetarët. Angazhimi kryesor që “Asnjë të mos mbetet pas” përbën parimin kyç të të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

E drejta për strehim është sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 59, pika 1, gërma “b”, lidhur me objektivat social, ku parashikohet shprehimisht se: “*Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim*”.

Theksojmë se ligjvënësi ka vendosur mekanizmat ligjorë dhe mjetet proceduriale në dispozicion të bashkive/organeve të pushtetit vendor, për të mundësuar që ato të vinë në ndihmë të shtresave në nevojë. Legjislacioni i shërbimeve sociale në thelb synon plotësimin e nevojave të shtetasve dhe familjeve të varfra. Sidomos kur kemi të bëjmë me familje/individë në nevojë

¹ Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication>, e aksesueshme në dhjetor 2015.

për mbështetje, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës është i rëndësishëm, me qëllim garantimin e mbrojtjes sociale, për identifikimin e vlerësimit e çdo rasti.

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe aktet nënligjore, përfaqësojnë një kapërcim të qenësishëm cilësor në mënyrën si perceptohet strehimi i përballueshëm, si adresohen grupet në nevojë, dhe si hartohen programet e veçanta të strehimit. Ky ligj parashikon parimet për strehim të përshtatshëm², duke përcaktuar edhe kriteret që e klasifikojnë strehimin e përshtatshëm³ si dhe llojet e programeve të strehimit⁴.

Nga ana tjetër, mirëqeverisja, e cila afirmohet në mënyrë të veçantë nga Karta e të Drejtave Themelore e BE, duhet të konsiderohet si një koncept prioritar në veprimtarinë e përditshme të organeve publike. Rritja e standardit të shërbimeve publike të ofruara nga organet e administratës në çdo nivel është në qendër të politikave dhe angazhimeve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Europian dhe përafrimit të legjislacionit tonë me Acquis Communautaire. Një iniciativë që tregon angazhim në këtë drejtim është Dokumenti i politikave të standardeve të shërbimeve në Shqipëri, i cili shqyrton sfidat që hasen në përkufizimin e standardeve të shërbimeve publike, si dhe paraqet kornizën e përgjithshme dhe zgjidhjet praktike të politikave për të nxitur zhvillimin e standardeve të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve.

Njësia e Vetqeverisjes Vendore ka detyrimin të luajë një rol proaktiv, udhëhequr nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi⁵. Bashkia, si njësi bazë e vetqeverisjes vendore, është e veshur me përgjegjësi efektive që mundësojnë një drejtim efikas, afër qytetarit.

Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet dhe angazhimin e deritanishëm të Bashkisë Vlorë, megjithë mundësitë e kufizuara, për vendosjen e prioritetëve lidhur me përmirësimin e kushteve të jetesës dhe për përfitimin nga programet e strehimit, apo trajtimin e këtij rasti sipas legjislacionit në fuqi.

Por masat e ndërmarra janë të pamjaftueshme dhe të mbartura në kohë, përse rezulton që problematika vijon të adresohet nga qytetarët, pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Hartimi dhe miratimi i projekteve nga Bashkia që adresojnë këto sfida duhet të sigurojnë që ndërhyrja të jetë e shpejtë, efektive dhe e qendërzuar. Përkushtimi i organeve të qeverisjes vendore për të adresuar konkretisht

² Nen 3-10, Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”.

³ Neni 4 “Parimet e strehimit të përshtatshëm”, Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”.

⁴ Neni 11, Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”.

⁵ Ky parim në pikën 2, të nenit 2, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkufizohet si: “...e drejta dhe aftësia e njësive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”.

nevojat emergjente të banorëve, reflektohet mbi të gjitha duke siguruar realizimin dhe zbatimin e masave në tërësi dhe në një kohë sa më të shpejtë. Kjo siguron që angazhimi për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, të mos jetë vetëm një koncept, por të kthehet në ndryshim konkret dhe të qëndrueshëm në realitetin lokal.

Gjendja e vështirë e jetesës në kushte të papërshtatshme të kësaj familje, identifikon nevojën e mbështetjes emergjente, por dhe të vazhdueshme e të përhershme, nëpërmjet marrjes së masave të shpejta dhe efikase, për krijimin e kushteve normale të jetesës, me qëllim arritjen e standardeve më të larta të integritetit të qytetarëve nga ana e organeve me kompetenca ekzekutive dhe përfaqësuese, në këtë bashki.

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se Bashkia Vlorë me gjithë përpjekjet, nuk ka marrë masa të mjaftueshme për zgjidhjen e problematikës së ankueses. Konkretisht nuk i është dhënë zgjidhje përfundimtare edhe rekomandimeve të sipërcituara nga Instituti i Ndërtimit, i dërguar pranë Bashkisë me shkresën nr. 191/3 prot., datë 01.04.2022.

Në këto kushte rezulton se Bashkia Vlorë nuk ka orientuar zgjidhjen e kësaj problematike, pasi banesa është konsideruar me rrezikshmëri të lartë për sigurinë e jetës. Institucioni i Avokatit të Popullit kupton se mjetet e Bashkisë janë të kufizuara, por informimi i përshtatshëm i banorëve dhe planifikimi duhet të ishin më të kujdesshëm për sa kohë kushtet e banesës janë të tilla.

Edhe pse rekomandimet⁶ kanë qenë të qarta për përfundimin e themelit të objektit, të truallit të ndërtimit përcaktuar pas një studimi të detajuar gjeologo-inxhinierik, përfundim i të gjithë mureve mbajtëse, nyjeve të bashkimit dhe brezave të konstruksionit të çatisë, rindërtim i pjesshëm i çatisë, këto rekomandime nuk janë zbatuar po kanë mbetur ende në një procedurë të papërfunduar, me rezultat mohimin e të drejtave të qytetares. Për pasojë të mosveprimeve të Bashkisë Vlorë, ndërtesa as nuk është shembur e as nuk është rindërtuar sipas projektit arkitektonik dhe konstruktiv bazuar në kodet moderne të projektimit.

Gjithashtu, nga rasti në fjalë konstatohet se Bashkia Vlorë nuk ka adresuar qartë programin e përfituar për këtë familje, konkretisht nëse familja e ankueses duhet të trajtohet sipas VKM nr. 329/2012 apo nëse ankuesja duhet të trajtohet vetëm në bazë të programeve sociale të strehimit.

⁶ Sipas akt-eskpertimit të Intitutit të Ndërtimit, amortizimi i theksuar në vite është 48.75% dhe referuar nenit 34 , pika 4 e Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”, parashikohet se nëse studimi i thelluar, ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së ndërtimit nga e para e ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës, vendos shembjen e detyruar të objektit, e cila kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 35 të këtij akti, procedurën të cilën bashkia nuk e ka kryer ende, duke rrezikuar edhe banorët e kësaj familje.

Më konkretisht, sipas VKM nr. 329/2012, në kreun 3, “Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile” parashikohet procedura në mënyrë të qartë që duhet të ndiqet në rastin kur ka pasur fatkeqësi natyrore dhe shteti duhet të fillojë procedurat për ndihmë shtetërore financiare.⁷ Duket sikur Bashkia Vlorë ka filluar një procedurë të tillë për të akorduar ndihmë shtetërore financiare në bazë të këtij akti ligjor, por procedura nuk është finalizuar. Më konkretisht, sikurse evidentohet më sipër, në një shkresë Bashkia Vlorë shprehet se në muajin nëntor 2021 nuk janë evidentuar dhe nuk ka patur dëme nga fatkeqësia natyrore si pasojë e shirave në këtë periudhë. Ndërkohë, që në shkresa të tjera Bashkia Vlorë shprehet se familja e ankueses nuk plotëson kriterin për dokumentacionin e nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare, sipas VKM-së nr. 329/2012, siç është kriteri i “*Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licensuara, nëse është rrëshqitje toke*”. Po ashtu, nga ana tjetër, në raport ekspertimin e Institutit të Ndërtimit, konstatohet se: “*Godina ka plasaritje të mureve....Këto plasaritje kanë ardhur si rezultat i uljes së themeleve të godinës të cilat kanë ardhur nga rrëshqitja e dheut, sidomos pas shirave të rrëmbyeshme të muajit nëntor 2021*”, duke cituar si bazë ligjore

⁷ Në rastin kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile, fatkeqësisë natyrore, ndiqen këto procedura:

1. Procedurat e vlerësimit të dëmeve

a) Familjet që kanë pësuar dëme, shkaktuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, paraqesin kërkesën e tyre për ndihmë financiare pranë organit të qeverisjes vendore përkatëse.

b) Drejtuesi i organit të qeverisjes vendore verifikon vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesë, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të tij, i cili mban dhe procesverbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara. c) Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e hartimit të procesverbalit është 5 (pesë) ditë. ç) Sipas rastit, me kërkesë të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, këshilli i qarkut përkatës krijon komisionin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit, i cili pas vlerësimit të dëmeve sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën “ç” të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi, përcakton masën e dëmshpërblimit për familjet e dëmtuara....e) Bashkia ose komuna harton kërkesën për dhënien e ndihmës së menjëhershme, për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkohshme për jetesë të qytetarëve, si dhe për shpenzime të tjera për përballimin e situatës emergjente. ë) Këshilli i komunës ose i bashkisë, pas shqyrtimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes dhe të dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare, në të cilin përmendet dhe masa e ndihmës së dhënë nga ky organ...

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

a) Procesverbali i konstatimit të gjendjes; b) Vendimi i këshillit të komunës ose i bashkisë; c) Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit, si dhe dëmeve në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake;....e) Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licensuara, nëse është rrëshqitje toke;....f) Shkresa nga njësitë e qeverisjes vendore dhe këshilli i qarkut, ku të shprehet masa e ndihmës së dhënë për familjen e dëmtuar, në rast se ka, ose pamundësia financiare për ta ndihmuar, për mungesë fondesh. 3. Përcaktimi i ndihmës financiare....dh) Kur studimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar rekomandon ndërtimin e banesës së re në një vend tjetër, akordimi i fondeve jepet pas miratimit të lejes së ndërtimit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. e) Dosjet me dokumentacionin përkatës të familjeve të dëmtuara, për të cilat nga ana e njësisë të qeverisjes vendore nuk është akorduar ndihma e nevojshme, sipas kriterëve të këtij vendimi, dërgohen pranë DPEC-së, në Ministrinë e Brendshme, me shkresë përcjellëse të konfirmuar nga institucioni i prefektit të qarkut. ë) Bazuar në dokumentacionin e dërguar, vlerësuar e argumentuar nga DPEC-ja, Ministria e Brendshme akordon fonde nga buxheti i saj, të miratuara në programin “Emergjencat civile”, ose i propozon Këshillit të Ministrave dhënien e ndihmës banorëve të dëmtuar, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave....

Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”⁸.

Gjithashtu, sikurse vetë Bashkia Vlorë pohon rezulton se Drejtoria e Mbrojtjes Civile ka referuar rastin pranë Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Investimeve Publike pranë Bashkisë, për përfshirjen e banesës së ankueses në programin “*Përmirësimi i kushteve fizike të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*”, ndonëse pa rezultat konkret.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e një cilësie jetese më të mirë për qytetaren dhe familjen e saj, në Bashkinë Vlorë, bazuar në:

- Nenin 1, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ku parashikohet shprehimisht se: “*Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave*”;
- Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku parashikohet shprehimisht se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”;
- Në vijim të nenit 21/b, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “*Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime: paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut... ”.*

REKOMANDOJMË

- Evakuimin e banorëve nga kjo banesë pasi paraqet rrezikshmëri të konsiderueshme;
- Hartimin e një plani konkret për adresimin e problematikës së ankueses, duke përfunduar procedurën e plotë qoftë edhe duke e përfshirë ankuesen në një program tjetër social;
- Përfundimin e të gjithë procedurave dokumentare dhe financiare për banesën e znj. N. M., për zgjidhjen përfundimtare të strehimit të saj dhe të familjes së saj, bazuar edhe në parashikimet e ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe akteve nënligjore përkatëse si dhe përshirjen në programet e strehimit social (bonus qiraje), gjatë përfundimit të procedurave në programe sociale deri në zgjidhjen e strehimit të saj;
- Përmirësimin e bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit;

⁸Sipas këtij raporti është cilësuar se: “Njësia e Vetëqeverisjes vendore vendos shembjen e detyruar të objektit, dhe e kryhen atë sipas procedurës së parashikuar në nenin 35, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

K O M I S I O N E R E

ERINDA MELI